



## **INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**

### **RAPORT SPECIAL NR.11**

**mbi**

**dështimin e Kryetarit të Gjykatës Komunale në Ferizaj për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë**

**drejtuar**

**Kuvendit të Kosovës**

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në Kosovë, në pajtim me nenin 4.3 dhe 4.10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullën 16, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, më **6 prill 2007**,

ka publikuar raportin në vijim:

**pdfMachine**

**A pdf writer that produces quality PDF files with ease!**

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, simply open the document you want to convert, click "print", select the "Broadgun pdfMachine printer" and that's it! Get yours now!

## BAZAT PËR RAPORTIN

1. Ky Raport bazohet në letrat që Zëvendës Ombudspersoni dhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ia kanë dërguar Gjykatës Komunale në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm “Kryetari i Gjykatës”) gjatë periudhës kohore nëntor 2005 deri më dhjetor 2006.

## QËLLIMI I RAPORTIT

2. Ky Raport shqyrton pajtueshmërinë e mosveprimit të Kryetarit të Gjykatës me nenet 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, i cili kërkon nga autoritetet publike që t’i përgjigjen kërkesave të Institucionit të Ombudspersonit brenda një kohe të arsyeshme.
3. Ky raport përfshin të gjitha rastet e paraqitura në Institucionin e Ombudspersonit gjatë periudhës së lartpërmendur gjatë së cilës Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ose Zëvendësi i tij kërkuan informata nga Kryetari i Gjykatës, ndërsa ai dështoi që të bashkëpunojë me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

## HEQJA DORË NGA PËRGJEGJËSIA

4. Asgjë nga përmbajtja e këtij Raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtoj dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar juridikcionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

## PROCEDURA PRANË INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT

5. Prej muajit nëntor 2005 deri në dhjetor 2006, disa ankues kanë paraqitur ankesa në Institucionin e Ombudspersonit, duke u ankuar për zvarritje të procedurave civile dhe penale në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
6. Zëvendës Ombudspersoni dhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, për secilin ankues ndaras i kanë dërguar letra dhe më pas letra rikujtuese Kryetarit të Gjykatës, me të cilat kërkonin informata lidhur me pohimet e ankuesve.
7. Më 5 maj 2006, si rezultat i numrit të madh të ankesave, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i bashkoi të gjitha ankesat kundër Gjykatës Komunale dhe i regjistroi ato nën një rast me emër “Abdyl Beqa dhe të tjerë kundër Gjykatës Komunale në Ferizaj.
8. Me 5 maj 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, i dërgoi letër Kryetarit të Gjykatës, duke i kërkuar informata për rrjedhën e procedurave gjyqësore të

ankuesve. Kopja e kësaj letre iu dërgua edhe Ministrit të Drejtësisë, Koordinatorit për Standarde në Qeverinë e Kosovës, Kryetarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe Koordinatorës së Njesisë së Inspektionit Gjyqësor të Kosovës, pranë Departamentit të Drejtësisë në UNMIK.

9. Me 19 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, i dërgoi letër Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si instancë më e lartë ndaj Gjykatës Komunale. Kopja e kësaj letre iu dërgua edhe Ministrit të Drejtësisë.
10. Me 6 korrik 2006, njeri prej ankuesve erdhi në Institucionin e Ombudspersonit dhe e informoi Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit se nuk kishte pasur kurrfarë zhvillimesh të reja në rastin e tij në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
11. Me 3 tetor 2006, përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit u takuan me Kryetarin e Gjykatës, ku kërkuan nga ai të përgjigjej në letrat e dërguara nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit. Gjatë takimit, Kryetari i Gjykatës u premtoi atyre se në të ardhmen do t'i përgjigjej kërkesave të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.
12. Deri në fund të tetorit 2006, Kryetari i Gjykatës nuk ishte përgjigjur në asnjë nga kërkesat e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.
13. Me 31 tetor 2006, gjatë vizitës së rregullt të përfaqësuesit të Institucionit të Ombudspersonit në Komunën e Ferizajt, ai vizitoi edhe Gjykatën Komunale në Ferizaj, ku bisedoi me administratoren e Gjykatës Komunale në Ferizaj për rastet e lartpërmendura, e cila gjithashtu premtoi se së shpejti do të kthehen përgjigjet e kërkuara nga Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.
14. Me 26 dhjetor 2006, përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit përsëri përsëri, gjatë vizitës së rregullt në Komunën e Ferizajt, vizitoi edhe Gjykatën Komunale në Ferizaj. Në këtë rast, ai përsëri u takua me administratoren e Gjykatës Komunale në Ferizaj lidhur me rastet e lartpërmendura. Gjatë takimit, administratorja tha se kërkesat e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit u janë dërguar secilit gjykatës kompetent për rastet përkatëse.
15. Me 26 janar 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit zyrtarisht hapi hetimet për këtë rast.
16. Deri në nxjerrjen e këtij raporti, Gjykata Komunale në Ferizaj nuk u përgjigj në asnjë nga kërkesat e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.

## **INSTRUMENTET RELEVANTE**

17. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 (më 12 dhjetor 1999) mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 (më 27 tetor

2000) (në tekstin e mëtejshëm, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59), në pjesën përkatëse, thotë:

1.1 Ligji i zbatueshëm në Kosovë do të jenë:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të lëshuara lidhur me to; dhe

[...]

18. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/09 për ( 15 maj 2001) në pjesën përkatëse, thotë:

[ ... ]

Ombudspersoni

Neni 10.1 Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë, pa pasur frikë apo kërcenim për masë ndëshkimore, të bëjnë ankesa pranë një zyre të pavarur në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe veprimeve që përbëjnë shpërdorim të pushtetit nga çfarëdo organi publik i Kosovës.

Neni 10.2 Zyra e Ombudspersonit, në pajtim me legjislacionin e UNMIK-ut në fuqi, ka juridiksion të marrë dhe të hetojë ankesa, të vëzhgojë, të marrë masa parandaluese, të bëjë rekomandime dhe të jep këshilla për çdonjërin prej këtyre çështjeve.

19. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë (16 shkurt 2006 ), në pjesën përkatëse, thotë:

Neni 3.1 Institucioni i Ombudspersonit ka kompetenca për të pranuar dhe hetuar ankesat nga çdo banor i përhershëm i Kosovës apo nga person fizik a juridik në territorin e Kosovës lidhur me shkeljen e standarteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të përfshira në ligjin dhe aktet në fuqi, duke përfshirë këtu edhe mosndërmarrjen e veprimeve, që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës.

[...]

Neni 4.6 Institucioni i Ombudspersonit i ndërmerr të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas nenit 3.1, duke përfshirë këtu edhe intervenimin e drejtëpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës nga neni 3.1, nga autoritetet kompetente kërkohet që të përgjigjen me nguti.

[...]

Neni 4.8 Institucioni i Ombudspersonit ka qasje në dosjet dhe dokumentet e çdo institucioni të Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në

pdfMachine

**A pdf writer that produces quality PDF files with ease!**

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, simply open the document you want to convert, click "print", select the "Broadgun pdfMachine printer" and that's it! Get yours now!

shqyrtim dhe sipas kësaj Rregulloreje, mund të kërkojë nga çdo institucion i Kosovës dhe nga personeli i tyre që të bashkëpunoj me institucionin e Ombudspersonit, duke siguruar informacione relevante, dokumente dhe dosje. Ndonjë institucion i Kosovës mund të refuzojë dhënien e dosjeve ose dokumenteve institucionit të Ombudspersonit në rrethanat në të cilat, në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, refuzimi i dhënies së dokumentit të Ombudspersonit shprehimisht është i lejuar, me kusht që arsyet t'i paraqiten Institucionit të Ombudspersonit me shkrim. Institucioni i Ombudspersonit mund të nxjerr konkludime të tilla që nga refuzimi i dhënies së dosjeve ose dokumenteve i sheh të përshtatshme.

[...]

## ANALIZA

20. Ombudspersoni konsideron se dështimi i Kryetarit të Gjykatës për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit ngritë çështje serioze sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë, në pjesën përkatëse, thotë:

[...] “Zyra e [Ombudspersonit], në pajtim me legjislacionin e aktual në fuqi, ka juridiksion të pranojë dhe të hetojë ankesa, të vëzhgojë, të marrë masa parandaluese, të bëjë rekomandime dhe të jep këshilla për çdonjërin prej këtyre çështjeve.

[...]”

21. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, në pjesën përkatëse, thotë:

[...]

Neni 4.6

Institucioni i Ombudspersonit i ndërmerr të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas nenit 3.1, duke përfshirë këtu edhe intervenimin e drejtëpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohej që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës nga neni 3.1, nga autoritetet kompetente kërkohej që të përgjigjen me ngut.

Neni 4.8

Institucioni i Ombudspersonit [...] mund të kërkojë nga cilido person që të bashkëpunojë me të për t'i dhënë informata, dokumente dhe dosje përkatëse [...].

22. Bazuar në atë që u tha më lartë, Ombudspersoni mund t'i drejtohet autoriteteve publike dhe të kërkojë nga ato që të intervenojnë në raste të veçanta apo të

suspendojnë ekzekutimin e vendimeve të veta. Ai gjithashtu mund të kërkojë informata, dokumente apo qasje në dosje të caktuara.

23. Sipas rregulloreve të lartpërmendura, autoritetet publike, përfshirë këtu edhe Kryetarin e Gjykatës, kanë obligime të caktuara që të ndihmojnë Ombudspersonin në punën e tij. Në veçanti, ato janë të obliguara t'i përgjigjen kërkesave të tij brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe t'i sigurojnë atij çfardo informate, dokumenti apo dosje të cilat i kërkon.
24. Në mes muajit nëntor 2005 dhe dhjetor 2006, Zëvendësi i Ombudspersonit dhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, gjatë zhvillimit të hetimeve bazuar në ankesat e shumë individëve që ankoheshin për zgjatje të procedurave gjyqësore në Gjykatën Komunale në Ferizaj, i dërguan Kryetarit të Gjykatës një numër të madh letrash, por kurrë nuk pranuan përgjigje për asnjë nga këto intervenime, pavarësisht se ishin dërguar letra rikujtuese.
25. Duke mos u përgjigjur në asnjë nga intervenimet apo kërkesat e Ushtruesit të Ombudspersonit, Kryetari i Gjykatës nuk ka vepruar sipas obligimeve që i ka si autoritet publik ndaj Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë të përcaktuara nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6.

## KONKLUDIM

26. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, konkludon se dështimi i Kryetarit të Gjykatës për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit, në lidhje me ankesat e individëve, të cilat janë në kompetencë të Gjykatës Komunale, është në kundërshtim me obligimet e autoriteteve komunale që burojnë nga neni 4.6 dhe 4.8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë. Dështimi i Kryetarit të Gjykatës për të vepruar sipas këtyre dispozitave, gjithashtu, ishte në kundërshtim me parimet e qeverisjes së mirë.

## REKOMANDIMET

27. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit rekomandon që Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, do të duhej që, jo më vonë se më **5 maj 2007**:
  - të sigurojë që Kryetari i Gjykatës Komunale në Ferizaj t'i përgjigjet pa vonesë të mëtejshme kërkesave dhe intervenimeve të mëparshme dhe të ardhshme të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.
  - ta informojë Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura, në pajtim me nenin 4.10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

28. Ombudspersoni, më tutje, rekomandon që Këshilli Gjyqësor i Kosovës, do të duhej që, jo me vonë se më **20 prill 2007**:

- të sigurojë që të bëhet shpërndarja e kopjeve të këtij raporti në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Hilmi Jashari  
Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

**pdfMachine**

**A pdf writer that produces quality PDF files with ease!**

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, simply open the document you want to convert, click "print", select the "Broadgun pdfMachine printer" and that's it! Get yours now!